



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:092277
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05690111

Ac.nr.3101/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Nsh. “M..... e B....”, të cilën me autorizim nga Autoriteti i Likuidimit e përfaqëson Xh.....S.... –zyrtar ligjor pran AKP- Zyra Regjionale në Gjilan, kundër të paditurit M..... D..... nga Gjilani, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av.A..... S..... nga Prishtina, me objekt kontesti pagesën e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil C.nr.648/18, të datës 07.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa themeltë ankesa e paditëses të paditëses Nsh. “M..... e B.....”, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil C.nr.648/18, i datës 07.12.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.648/18, të datës 07.12.2020 në pikën e I-rë të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar me ligj kërkesëpadinë e paditëses Nsh. “M..... e B.....”, të cilën me autorizim nga Autoriteti i Likuidimit e përfaqëson Xh..... S.... – zyrtar ligjor, e ushtruar ndaj të paditurit M.....D..... nga Gjilani me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditëses, t’ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 2,449.50 euro, në emër të pagesës së borxhit, me kamatë prej 3.5%, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 26.03.2010 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar secilën palë që ti bart shpenzimet e veta.

Kundër këtij Aktgjykimit brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar paditësja për shkak të shkëljes së dispozitive të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimi i atakuar të priset ashtu që Gjykata e Apelit të vendos lidhur me këtë çështje apo që çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e paditëses është pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, “M..... e B.....”, përmes përfaqësuesit të saj Xh..... S.....-zyrtat ligjor pranë AKP-zyra regjionale në Gjilan, me datë 26.03.2010, ka ushtuar padi kundër të paditurit M..... D.... nga Gjilani, me objekt kontesti pagesën e borxhit. Në padi ka cekur se ndërmarrja shoqërore “M.....e B.....`I`A\A s”, me seli në Gjilan ishte dakorduar sipas marrëveshjes verbale me të paditurin M..... D..... nga Gjilani, për shitëblerjen, furnizimin, transportin, shtrirjen dhe ngjeshjen e bito agregatit nga fraksionet 0/22mm, me trashësi t=6cm. Të paditurit disa herë i është kërkuar borxhi në formën verbale, e i njëjti asnjëherë nuk iu ka përgjigjur kërkesës së paditëses, andaj duke u bazuar në dëshmitë sic janë fatura dhe fletë dërgesat i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë e paditëses, dhe ta obligoj të paditurin që të paguaj në emër të borxhit vlerën prej 2,449.50 euro, me kamatë ligjore duke filluar nga data 22.07.2004, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kanosje të përmbarimit të dhunshëm.

I padituri, përmes përgjegjës në padi të ushtruar me datë 19.04.2011, e ka kundërshtuar padinë e paditësit si të pa bazuar me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar kurrfarë prove se me të paditurin kanë lidhur dhe nënshkruar kontratë apo marrëveshje me shkrim nga e cila do të shihej qartë se i njëjti me të vërtetë i ka borxh paditëses, për këtë arsye i ka propozuar gjykatës që të refuzohet kërkesëpadija e paditësit, dhe të obligohet paditësja që ti kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.648/18 të datës 07.12.2020, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë si të pa themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se nga fatura me numër 236/04, gjykata ka konstatuar se paditësja “M..... e B.....”, ka faturuar për furnizim, transport, shtrirje dhe ngjeshje të bito agregatit nga fraksionet 0/22m, me trashësi t=6cm, në shumën prej 2,449.50 euro, por e njëjta është e faturuar dhe e nënshkruar nga drejtori, ndërsa nuk është e pranuar dhe

nënshkruar nga ana e të paditurit M..... D..... Nga fletëdërgesa me numër 0398 e datës 22.07.2004, gjykata konstatoi faktin se nga ana e paditëses është furnizuar me bito zhavor i padituri M..... D....., në sasinë prej 12 m³, e cila është vërtetuar dhe dorëzuar nga zyrtari që punon tek paditësja, ndërsa nuk është nënshkruar dhe pranuar nga i padituri M..... D..... Nga fletë dërgesa me numër 0394 e datës 22.07.2004, gjykata konstatoi faktin se nga ana e paditëses është furnizuar me bito zhavor i padituri M..... D....., në sasinë prej 12 m³, e cila është vërtetuar dhe dorëzuar nga zyrtari që punon tek paditësja, ndërsa nuk është nënshkruar dhe pranuar nga i padituri M.....D..... Nga fletë dërgesa me numër 001000000 e datës 22.07.2004, gjykata konstatoi faktin se nga ana e paditëses është furnizuar me bito zhavor i padituri M..... D....., në sasinë prej 10 m³, e cila është vërtetuar dhe dorëzuar nga zyrtari që punon tek paditësja, ndërsa nuk është nënshkruar dhe pranuar nga i padituri M.....D..... Nga fletë dërgesa me numër 0392 e datës 22.07.2004, gjykata konstatoi faktin se nga ana e paditëses është furnizuar me bito zhavor i padituri M..... D....., në sasinë prej 12 m³, e cila është vërtetuar dhe dorëzuar nga zyrtari që punon tek paditësja, ndërsa nuk është nënshkruar dhe pranuar nga i padituri M..... D..... Nga fletë dërgesa me numër 0395 e datës 22.07.2004, gjykata konstatoi faktin se nga ana e paditëses është furnizuar me bito zhavor i padituri M..... D....., në sasinë prej 12 m³, e cila është vërtetuar dhe dorëzuar nga zyrtari që punon tek paditësja, ndërsa nuk është nënshkruar dhe pranuar nga i padituri M..... D..... Nga e fletëdërgesa me numër 0397 e datës 22.07.2004, gjykata konstatoi faktin se nga ana e paditëses është furnizuar me bito zhavor i padituri M.... D....., në sasinë prej 12 m³, e cila është vërtetuar dhe dorëzuar nga zyrtari që punon tek paditësja, ndërsa nuk është nënshkruar dhe pranuar nga i padituri M..... D..... Nga certifikata e pronës me numër të lëndës 688-2014 të datës 28.01.2014, gjykata konstaton se kjo ngastër në sipërfaqe prej 293 m², në vendin e quajtur “Rasadnik”, është e regjistruar në emër të P.Sh. Stacioni për Përparimin e Bujqësisë. Nga provat e shtjelluara, gjykata kontatoi se paditësja “M..... e B.....” dhe i padituri M..... D.....nuk kishin nënshkruar ndonjë kontratë me shkrim siç e parashohin dispozitat e LMD-së, lidhur me obligimet të cilat do të merren përsipër nga palët ndërgjyqëse dhe me të cilin do të vërtetohej raporti juridik në mes të palëve ndërgjyqëse, për punët të cilat do të kryheshin. Faturat të cilat paditësi i ka dorëzuar si provë konstatohet se faktuar janë përpiluar vetëm nga ana e paditëses, mirëpo nga ana e të paditurit nuk janë pranuar dhe gjithashtu nuk ka asnjë dëshmi se e njëjtat janë pranuar në ndonjë mënyrë tjetër si përmes postës apo në mënyrë elektronike. Në fund gjykata e refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa themeltë duke e mbështetur vendimin e saj në nenin 319.1 dhe nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-ës. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi konform nenit 450 i LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar pala ankuese me ankesë, andaj, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par.4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën.

Nga shkresat e lëndës rezulton se faturat të cilat paditësi i ka dorëzuar si provë janë përpiluar vetëm nga ana e paditëses dhe nuk janë pranuar nga ana e të paditurit, po ashtu nuk ka asnjë dëshmi se të njëjtat fatura janë pranuar në ndonjë mënyrë tjetër si përmes postës apo në mënyrë elektronike. Bazuar në nenin 7.1 të LPK-së *“Palët kanë për detyrë të paraqesin te gjitha faktet mbi te cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe te propozojnë prova me te cilat konstatohet faktet e tilla”*. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike e po ashtu edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë ashtu që nuk është kontestues fakti se paditësja “M..... e B.....” dhe i padituri M..... D..... nuk kishin nënshkruar ndonjë kontratë me shkrim siç e parashohin dispozitat e LMD-së, lidhur me obligimet të cilat do të merren përsipër nga palët ndërgjyqëse dhe me të cilin do të vërtetohej raporti juridik në mes të palëve ndërgjyqëse, për punët të cilat do të kryheshin. Në anën tjetër, paditësja nuk ka arritur të provojë faktin se i padituri i ka borxh shumën e kërkuar sipas kërkesëpadisë ngase fatura të cilën paditësi e ka ofruar si provë është e përpiluar vetëm nga ana e paditëses dhe fatura nuk është e pranuar nga ana e të paditurit, andaj bazuar në nenin 319.1 dhe nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, ku neni 319.1 ka paraparë *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, kurse neni 322.1 ka paraparë *“në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, ndërsa neni 322.2 ka paraparë *“pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Nga provat e administruara dhe të elaboruara më lartë, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësja nuk arriti të provojë faktin se a ka qenë në raport juridik kontraktual me të paditurin, dhe se i padituri i ka borxh paditëses dhe në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit. Si rrjedhojë e kësaj, është vendosur që aktgjykimit i atakuar të vërtetohet, e të refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses.

Po ashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, me arsyetim se Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të paditëses, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3101/21, datë 08.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi